

Procesverbal

Konsultim publik : *Me Banorët e Njesisë Administrative Kurvelesh*

Data : 10/12/2025

Ora : 10:00

Vendi: Qendra e fshatit Progonat

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 25 persona të pranishëm. (7 gra dhe 18 burra).

1.Titulli i Projekt – aktit që konsultohet: Projekt draftet programi buxhetor afatmesem 2026-2028, paketa fiskale, dhe planifikimi për buxhetin e vitit 2026.

2. Pjesëmarrës :

- 1. Gramos Sako** (Kryetar i Bashkisë)
- 2. Arben Gumeni** (Kryetari Keshilli Bashkisë)
- 3. Valbona Cela** (Sekretare Këshilli)
- 4. Ela Skenderaj** (Kordinatore informimit)
- 5. Ervin Panidha** (DPKZHT)
- 6. Adi Vala** (DSHP)
- 7. Gazmend Groshi,** (Drejtorja e Tatim Taksave)
- 8. Blerina Kasneci** (Drejtorja e Tatim Taksave)
- 9. Arta Shaha** (Drejtoresh Arsimit - Kulturës)
- 10. Gezim Shehu** (Drejtori Zhvillimi Rural)
- 11. Avni Abedini** (Drejtori Zhvillimi Rural)
- 12. Miftar Meta** (Anëtar Këshilli)
- 13. Aleksandër Toti** (Kabineti Kryetarit)

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen në dëgjuesën publike të organizuar për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 dhe Projektbuxhetin e vitit 2026. Ai theksoi se fokusi kryesor do të jetë të shërbimet bazë në komunitet, si pastrimi, ndriçimi publik, mirëmbajtja e varrezave, shtrimi i rrugëve, si dhe mbështetja për blegtorinë, duke ftuar pjesëmarrësit të paraqesin mendimet dhe nevojat e njësive të tyre për t'u përfshirë në buxhetin e vitit 2026.

Më pas, fjala iu dha Kryetarit të Bashkisë, z. Gramos Sako. Ju falenderoj për prezencën tuaj në këtë dëgjuesë publike.

Qëllimi i takimit është diskutimi i Projektbuxhetit të vitit 2026 dhe dëgjimi i problematikave të komunitetit. Bashkia ka fokusuar ndërhyrjet kryesisht në shërbimet bazë, si:

- mirëmbajtja e varrezave publike;
- rikonstruksioni i lrave;
- rikonstruksioni i rrugëve të brendshme.

Janë parashikuar investime për hapjen e rrugëve të brendshme në fshatrat Gusmar, Nivicë dhe Progonat, me fonde jashtë buxhetit të Bashkisë.

Gjithashtu, u bë me dije se procedurat për ujësjellësin e fshatit Gusmar dhe për ndërhyrjet në qendrën e fshatrave Progonat dhe Gusmar do të nisin në muajin janar.

Kemi n një projekt në bashkëpunim me FSHZ, për të cilin do flas z. Aleksandër Toti.

Z. Aleksandër bëri me dije se ndërtimi i qendrave të fshatrave Progonat dhe Gusmar do të realizohet me financim nga FZH, bazuar në ide të konsultuara me grupin e punës. Ai theksoi se faza e financimit dhe procedurat e prokurimit parashikohen të nisin në janar 2026.

Gjithashtu u theksua se në fshatin Progonat është parashikuar ndërtimi i një pike pritëse për turistët, restaurimi i sheshit të fshatit, rikonstruksioni i fushës së futbollit dhe basketbollit, si dhe restaurimi i objektit të ish-shkollës së vjetër, me qëllim kthimin e tij në një njësi pritëse në shërbim të turizmit.

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet si vijon :

-

- **Kryetari i fshatit Progonat Z. Ziflo Mema:**

Suksese Kryetar, si k/fshati kam kerkesa ne buxhet do shtoja kanalizimi i ujrave te zeza, restaurimi i stadiumit, ndricimi eshte i mire te jete funksional. Ngriti shqetësim për rrugët e brendshme të fshatit segmenti Qender- Kermaj. Lera ne Gradisht u tenderua, ajo aktualisht pa uje. Kërkoj gjithashtu që Mjeku i Familjes të vizitoj pensionistet sipas një kalendari në qëndren shëndetësore.

Z. **Gëzim**; Kemi diskutuar per lerat kontrata nuk është respektuar nga subjekti fitues, pasi punimet nuk janë përfunduar dhe nuk janë respektuar afatet e përcaktuara. Për këtë arsye, Bashkia ndodhet në proces të marrjes së masave administrative.Dy lera të tjera janë aktualisht në procedurë tenderimi. Gjithashtu, ju bej me dije se është miratuar plani i mbarështimit, i cili krijon mundësi edhe për pastrimin e kullotave.

Kryetari i Bashkisë; Sa kohë zgjat procedura e prokurimit.

Z. **Gëzim**; Problematikat lidhur me procedurat e tenderimit pritet të mbyllen brenda vitit.

- **Kryetari i Fshatit Rexhin Z. Jaho Xhebro:**

Ndërhyrje të menjëhershme në pastrimin e kullotave dhe përmirësimin e tyre në zonën e fshatit Rexhin, pasi situata paraqitet emergjente dhe kërkon investim të posaçëm. U theksua gjithashtu se tarifat e kullotave janë të larta, pasi janë miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Arben Gumeni: Çmimet janë në rritje. Edhe në Këshill kemi pasur kërkesa të përsëritura lidhur me tarifat.

Jaho : Kemi një kërkesë për fushën e shkollës në Nivicë dhe për ndërtimin e një muri mbrojtës. Fshatit i duhen gjithashtu gurë, ndaj duhet caktuar një pikë e posaçme nga ku të merret materiali. Kam shqetësimin për tre kërkesa për leje ndërtimi për banesa në fshat, të cilat ende nuk kanë marrë zgjidhje.

Z. Ervin Panidha; Do të mbledhë informacion lidhur me këtë problematikë, duke theksuar se bëhet fjalë për procedura që duhen përmbushur, por se ekziston hapësirë për shqyrtimin e mundësive ligjore për përshpejtimin dhe lehtësimin e tyre. Ai informoi se do të përgatisë një draft në këtë drejtim, çështja e lerave problematike në territor, duke kërkuar sqarime se si identifikohen dhe piketohen ato dhe nëse ndodhen në distancë të përshtatshme nga zonat e blegtorisë.

Z. Avni Abedini; Bashkia nuk disponon dokumentacion të plotë që nga periudha e tranzicionit, por disponon studimin dhe planin e mbarështimit deri në vitin 2000, sipas të cilit janë ndjekur ndërhyrjet ndër vite.

Ai bëri me dije se në muajin shtator është përgatitur regjistri i ndarë në ngastra, me të gjitha vendndodhjet, bazuar në planin e mbarështimit, dhe se çdo objekt dhe lere do t'i nënshtrohet procesit të përditësimit, ekzistojnë vështirësi në financim për shkak të kalimit të afateve, duke sugjeruar që të ardhurat nga qiratë e pyjeve dhe kullotave të kalojnë për financimin e rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së tyre. Ai shtoi se, kur kërkohen qira për antena, Bashkia është përpjekur të mbështesë edhe blegtorët përmes përmirësimit të rrugëve.

Gjithashtu, u bëj me dije se po krijohet regjistri i rrugëve.

Banori i fshatit Lekdush, z. Kreshnik Shehu:

- Kërkoi investime për dëkë tjetër pasi rrethimi i shkollës së Lekdushit, është kryer
- Kërkoi ndërtimin e shtegut dhe vendosjen e tabelave informuese të Ujëvara e Kuveleshit.
- Kërkoi vendosjen e tabelave orientuese në Njësinë Administrative Kurvelesh.

- **Kryetari i Fshatit Gusmar Z. Luan Meta:**

Rruget e brendshme të fshatit qendra e fshatit Gusmar, markimi i shtigjeve, Ujesjellesi i fshatit. Kalaja e Nivicës.

- **Banori i fshati Progonat Z. Ismail Guga :**
- Të vendoset tarifë afrofe nga ujësjetlesi per periudhen e dimrit në Njësinë Kurvelesh, për arsye se gjatë dimrit detyrohen ti lenë cezmat hapur për shkak se ngrin ujë nga temperaturat e ulëta.

Ju faleminderit!

Mbajtese e P/Verbalit Sekretare Këshillit

Valbona Çela



Kordinatore informimit konsultimit publik

Ela Skenderaj

